



FILLON HARTIMI I "STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2024-2030"

Ministria e Drejtësisë organizoi një tryezë pune me aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë për të filluar hartimin e "Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030". U adresuan sfidat dhe detyrimet e sistemit të drejtësisë, për të përmbushur objektivat e "Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës". Rruga drejt Bashkimit Evropian vazhdon!

MINISTRI MANJA PREZANTON DREJTORIN E RI TË PËRGJITHSHMË TË BURGJEVE

Në takimin me drejtuesit e IEVP-ve, Ministri Manja prezantoi Klevis Qosen në krye të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe u bë një analizë e problematikave që ka në sistemin e burgjeve, për t'u dhënë zgjidhjet e duhura. Siguria dhe standardet e trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve janë kryefjala e punës në çdo IEVP!



TAKIM ME DREJTORIN EKZEKUTIV TË TRANSPARENCY INTERNATIONAL NË BERLIN, Z. DANIEL ERIKSSON

Në këtë takim u nda qëndrimi i përbashkët se fokusi i luftës kundër korrupsionit duhet të jetë parandalimi, dhe se transparenca në vendimmarrje dhe reformat strukturore në fushat me risk të lartë korrupsioni duhet të jenë radikale! Vullneti politik, lidhshëpi me bazë integritetin e zyrtarëve publik, digjitalizimi i shërbimeve publike dhe përdorimi i IA në fushën e prokurimeve, janë rruga e duhur për të pasur një shoqëri imune ndaj korrupsionit dhe dëshmojnë qartësisht vizionin dhe vendosmërinë e qeverisë shqiptare për të adresuar si duhet sfidat e luftës kundër korrupsionit. Z. Eriksson shtroi nevojën për të pasur sa më shumë burime dhe indekse për gjendjen e korrupsionit në Shqipëri, me qëllim që indeksi i TI të jetë sa më objektiv dhe t'i shërbejë institucioneve publike për të përmirësuar performancën dhe transparencën e veprimtarisë së tyre. Manja e garantoi z. Eriksson se raporti i tyre mbi perceptimin e korrupsionit në Shqipëri, përkthehet në dokument pune për çdo institucion në Shqipëri. U ra dakord për të punuar ngushtësisht me TI, për të shkëmbyer përvojat e mira dhe për të marrë ekspertizën e duhur në luftën kundër korrupsionit!



TAKIM PUNE ME Z. MATTEO MECACCI, DREJTORIN E OSBE/ODIHR

Në këtë takim u diskutua për mbështetjen e OSBE/ODIHR për ecurinë e reformës zgjedhore dhe rolin e Ministrisë së Drejtësisë si institucion lider në hartimin e udhërrëfyesit për "Funksionimin e Institucioneve Demokratike", dokument kyç për integrimin në BE. Z. Mecacci vlerësoi progresin pozitiv të reformës në drejtësi, si garanci për zgjedhje të lira dhe të ndershme!



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministra_drejtises
ulsimanja



@manja_ulsi